



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
I.AGJ.nr.1/23-31
Datë 03.04.2023

Në bazë të nenit 14 parag. 1 të Ligjit për Gjykatat (nr. 06/L-054), Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 11 par. 1 dhe 3 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, si dhe planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Prizren me dy degët në Suharekë dhe Dragash, Kryetarja e Gjykatës Shpresa Emra, me datën 03.04.2023 përcakton:

**PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËVE TË GJYQTARËVE
DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE NË PRIZREN DHE DY DEGËVE
NË SUHAREKË DHE DRAGASH**

Neni 12

Plani vjetor I.AGJ.nr.1/22-105 i dt.21.12.2022 ndryshohet dhe plotësohet sa i përket gjyqtarëve të rinjë të emëruar Uran Zogaj dhe Diona Bajrami të cilët janë emëruar në Gjykatën Themelore në Prizren dhe gjyqtarja Vera Gashi e cila është caktuar si gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren dega në Suharekë.

Neni 13

Gjyqtarët Uran Zogaj, Diona Bajrami dhe Vera Gashi pas periudhës 3 (tre) mujore të trajnimit praktik fillestar nga dt.01.05.2023 caktohen si gjyqtarë në Divizion Civil (për çështje kontestimore dhe jo kontestimore).

Neni 14

Ky plotësim ndryshim i planit vjetor të punës, është pjesë përbërëse e planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Prizren dhe dy degëve në Suharekë dhe Dragash I.AGJ.nr.1/22-105 të datës 21.12.2022 i cili plan në pjesën që nuk është ndryshuar mbetet në fuqi.

Neni 15

Ky plan mund të ndryshohet dhe të plotësohet me vendim të Kryetarit, varësisht nga nevoja për organizim më të mirë të punëve, zgjidhjen më efektive të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të numrit të gjyqtarëve dhe strukturës së gjykatës.

Neni 16

Ky ndryshim i planit do të hyjë në fuqi dhe do të zbatohet pas aprovimit nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kryetarja e gjykatës Themelore në Prizren
Shpresa EMRA

